



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

---

**RELACION MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE  
PËR VITIN 2015  
PËR KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT**

Për periudhën janar- dhjetor 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përmbushur objektivat e auditimit të planifikuar duke e tejkaluar atë.

*Drejtimit kryesore të veprimtarisë audituese të ushtruar nga KLSH për vitin 2015 janë:*

- Zbatimi i dispozitave ligjore në fushën ekonomike, financiare, fiskale e kontabël, me synim identifikimin e gjendjes reale, të metat apo parregullsitë e mundshme në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve publike, dhe dhenien e rekomandimeve për përmirësimin e menaxhimit të financave publike.
- Respektimi i dispozitave dhe i procedurave ligjore në kryerjen e veprimeve financiare, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u fokusuar në veçanti në auditimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike, si dhe në auditimin e shpenzimeve kapitale me burim të brendshëm dhe të huaj financimi.
- Rregullshmëria dhe korrektësia e mbajtjes së dokumentacionit financiar dhe atij kontabël.
- Zbatimi i kërkesave të përcaktuara ligjore mbi paraqitjen e llogarive vjetore për raportimet buxhetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
- Funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe organizimin e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

-Kryerja e auditimeve të performancës si një prioritet i veprimtarisë audituese të KLSH-së e orientuar drejt praktikave më të mira të fushës.

Rezultatet përfundimtare të auditimeve të kryera dhe masat e rekomanduara për përmirësimin e gjendjes për çdo subjekt të audituar, u janë dërguar të gjithë subjekteve të audituara dhe, në disa raste të veçanta edhe institucioneve të tyre drejtuese.

Gjykuar në rëndësinë apo peshën që kanë zënë gjetjet në kontekstin e përdorimit të fondeve buxhetore, raportet dhe masat e rekomanduara u janë dërguar edhe institucioneve më të larta drejtuese të shtetit. Me rezultatet e auditimeve dhe masat e rekomanduara është njohur edhe publiku i gjerë, nëpërmjet përdorimit të formave të ndryshme të komunikimit e të informimit.

## **I. ANALIZA E REALIZIMIT TE BUXHETIT TE KLSH-SË PËR VITIN 2015**

Bazuar në Ligjin vjetor të buxhetit të shtetit të vitit 2015, me ndryshime KLSH ósë i është akorduar një fond në total prej 380.727,7 mijë lekë nga i cili 350.727,7 mijë lekë përfaqësonin financime nga burime të brendshme buxhetore dhe 30 milionë lekë nga burime të huaja. Me Aktin Normativ nr.2 datë 11.12.2015 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.160/2014,

Ëpër Buxhetin e Vitit 2015Ë u bënë ndryshime në zërin Investime me Financim të huaj duke hequr vlerën prej 30 milionë lekë.

Treguesit e buxhetit total ne nivel institucional referuar planit fillestar, ndryshimet gjate vitit dhe shpenzimeve faktike, paraqiten në tabelën si me poshtë vijon:

*Njësia në mijë/lekë*

Nr.	Artikujt	Plani Fillestar	Ndryshimet Gjate Vitit	Plani me ndryshime	Realizimi	Ne %	Diferenca
A	B	1	2	3	4	5	6
1	600 Paga	219.000,0	-4.000,0	215.000,0	208.334,2	96.8	6.665,8
2	601 Sigurime	27.000,0	4.000,0	31.000,0	30.815,0	99.4	185,0
3	602 Mallra dhe Shërbime	83.850,0		83.850,0	74.718,1	89.1	9.131,9
4	605 Transferta Korrente te huaja	150,0		150,0	129,0	86	21,0
A	Kuota anëtarësie	150,0		150,0	129,0	86,0	21,0
6	606 Transferta per Buxh. Fam.	727,7		727,7	727,7		0,0
7	Shpenzime Kapitale	50.000,0	-30.000,0	20.000,0	11.293,1	56.4	8.706,9
A	Financim I brendshëm: nga I cili	20.000,0		20.000,0	11.293,1	56.4	8.706,9
A.1	Investime	13.100,0		13.100,0	11.293,1	86.2	1.806,9
A.2	TVSH/financim i huaj	6.900,0		6.900,0	0,0	0	6.900,0
B	Financim I huaj nga I cili						
B. 1	Investime-Projekt	30.000,0	-30.000,0	0,0	0,0	0	0,0
	<b>Totali</b>	<b>380.727,7</b>	<b>-30.000,0</b>	<b>350.727,7</b>	<b>326.017,1</b>	<b>93,0</b>	<b>24.710,6</b>

Nga analiza faktoriale sipas kategorisë së shpenzimeve në nivel artikulli rezulton:

- Fondi i pagave është realizuar në rreth 97 % të kuotave të planifikuara,
- Fondi i Sigurimeve Shoqërore është realizuar 99 %,
- Fondi I shpenzimeve operative ëmallra dhe shërbime ë rezulton ne nivelin 89 % te kuotave te planifikuara.
- Buxheti i investimeve të planifikuara për òfurnitura dhe pajisjeë ne vlerën 11.3milionë lekë është realizuar në nivelin 100 % te objekteve te planifikuara duke reflektuar një kursim të fondeve prej rreth 1.8 milionë lekë .
- Shpenzimet me burim te huaj financimi me vlerë 30.000 mijë lekë, fonde këto te planifikuara për implementimin e projektit IPA me VKM nuk u bënë efektive për arsye se projekti IPA nuk filloi përgjatë 2015.

Situata buxhetore per vitin 2015 e analizuar në nivel artikulli rezulton:

**1. Pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore llog. 600-601**

a) Pagat nga 215.000 mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar 208.334,2 mijë lekë ose në masën 96.8 %.

b) Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga 31.000 mijë lekë të plani vjetor janë shpenzuar 30.815 mijë lekë ose në masën 99.4 %

Shuma e shpenzuar për zërin òpagaë përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontraktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

**2. Transferta korrente dhe të huaja (llog.605)**

Gjatë periudhës raportuese 2015 janë shlyer detyrimet për kuota antarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 129.040 lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara.

### **3. Transferta për buxhetet familjare dhe individët. (606)**

Për vitin 2015 fondi i veçantë rezultoi i realizuar në masën 100 % të fondit disponibël. Gjatë kësaj periudhe, është dhënë nga fondi i veçantë me kërkesat e bëra nga ana e jonë dhe të konfirmuar nga Ministria e Financave një fond prej 727.7 mijë lekë për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundje.

### **4. Shpenzimet operative 602**

Nga 83.850 mijë lekë plani vjetor janë shpenzuar 74.718,1 mijë lekë ose në masën 89.1 % . Nga analiza me e detajuar e realizimit të shpenzimeve rezultoi që në këtë nivel realizimi ka ndikuar diferenca (kursimet) nga proceset e prokurimit të fondeve në rreth 4 miliona lekë si dhe një pjesë e fondeve të shpenzimeve për udhëtim dhe dieta që kapin vlerën rreth 4 miliona lekë. Me këto ze shpenzimesh janë përballuar gjithashtu edhe mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si: shpenzime për drita, ujë, telefon etj. Në këtë artikull një pjesë të konsiderueshme e zënë shpenzimet për trajnime jashtë dhe brenda vendit dhe për dieta në funksion të veprimtarisë audituese. Ngritja e Kapaciteteve është një nga Objektivat Strategjikë të KLSH që parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit 2013 -2017. Për arritjen e këtij objekti, KLSH ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shume aktivitete trajnimi, takime dhe grupe pune, konferenca dhe simpoziume, të cilat kanë synuar ndërtimin e kapaciteteve , rritjen e aftësive dhe njohurive profesionale të audituesve në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit. Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete janë shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në menaxhim sa me të kujdesshem dhe përdorim sa më me efektivitet.

### **5. Shpenzimet për investime kapitale 231**

Bazuar në Ligjin e buxhetit të shtetit të vitit 2015 plani i buxhetit me destinacion investimet kapitale rezultoi në shumën 50 milionë lekë.

I detajuar sipas burimit të financimit rreth 20 milionë lekë përfaqësonin fonde buxhetore me burim të brendshëm financimi dhe 30 milionë lekë me burim të huaj. Me Aktin Normativ nr.2 datë 11.12.2015 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.160/2014, ÷Për Buxhetin e Vitit 2015÷ u bënë ndryshime në zërin Investime me Financim të huaj duke hequr vlerën prej 30 milionë lekë.

Më poshtë paraqitet realizimi i buxhetit të investimeve për vitin 2015 i detajuar sipas zerave:

*Mijë leke*

Nr.	Artikujt	Plani Fillestar	Ndryshimet Gjate Vitit	Fakti	Realizimi	Diferenca
A	B	1	2	3	4	5
1	Blerje pajisje kompjuterike	7.500,0	7.500,0	7.124,0	95,0	376,0
2	Blerje siguri rrjeti	1.200,0	1.200,0	1.176,0	98,0	24,0
<b>3</b>	<b>Softë kompjuterike</b>	<b>620,0</b>	<b>620,0</b>	<b>498,0</b>	<b>80,0</b>	<b>122,0</b>
<b>4</b>	<b>Infrastruktura</b>	<b>2.080,0</b>	<b>2.080,0</b>	<b>1.103,0</b>	<b>53,0</b>	<b>977,0</b>
<b>4</b>	<b>Pajisje zyresh</b>	<b>1.700,0</b>	<b>1.700,0</b>	<b>1.392,0</b>	<b>83,0</b>	<b>308,0</b>
<b>5</b>	<b>Totali investimeve furnitura pajisje</b>	<b>13.100,0</b>	<b>13.100,0</b>	<b>11.293,0</b>	<b>86,0</b>	<b>1.807,0</b>
6	TVSH/kosto lokale	6.900,0	6.900,0	0,0	0,0	6.900,0
7	Financim i huaj, IPA	30.000,0	0,0	0,0	0,0	0,0
	<b>Totali</b>	<b>50.000,0</b>	<b>20.000,0</b>	<b>11.293,0</b>	<b>56,4</b>	<b>8.707,0</b>

- Nga analiza faktoriale e buxhetit të investimeve sipas zërave konstatohet se buxheti i investimeve të planifikuara për ofurnitura dhe pajisjeë ne vlerën 11.3 milionë lekë duke reflektuar nje kursim të fondeve prej rreth 2 milionë lekë, si rezultat i zbatimit te procedurave te prokurimit dhe nivelit te larte te konkurrencës se ofertimit ne këto procedura.
- Fondi prej 6.9 milionë lekë i planifikuar për Kosto lokale e projektit IPA nuk u përdor gjatë vitit 2015 për shkak të mosbërjes efektive të marrëveshjes së financimit nga donatorët.

Struktura organizative e KLSH-së reflekton kërkesat e nenit 12 të Ligjit nr nr. 10296, datë 08/07/2010 për menaxhimin Financiar dhe Kontrollinë për sa i përket kriterëve të linjave të raportimit dhe arsimimit për nëpunësin zbatues. Nëpunësi zbatues ( Përgjegjësjë e Financës ka vartësi dhe raporton tek Sekretari i Përgjithshëm njëherazi nëpunësi autorizues i institucionit). KLSH ka hartuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të KLSH-së, e cila u është dhënë për zbatim dhe ndjekje çdo Drejtori Departamenti dhe Drejtorie .

## **II. ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TE KLSH-SE REFERUAR BUXHETIT TE ORIENTUAR NE REZULTATE:**

*Viti 2015 mund të konsiderohet viti i vazhdimësisë nëpërmjet konsolidimit të reformës institucionale në funksion të përmbushjes së objektivit kushtetues dhe ligjor të sigurimit të llogaridhënies publike. Gjithë veprimtaria audituese e KLSH-së reflekton më së miri dhe është produkt i ndryshimeve të thella rrënjësore në drejtim të implementimit të kërkesave të standardeve ndërkombëtare gjate ushtrimit të veprimtarinë audituese.*

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 154/2014, òMbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, KLSH u angazhua tërësisht për hartimin e kuadrit rregullator për të përmbushur detyrimet e tij institucionale në plotësimin dhe miratimin e akteve përkatëse nënligjore në zbatim të këtij ligji si dhe orientimin e veprimtarisë institucionale në përputhje me kërkesat e Standarteve Ndërkombëtare ISSAI.

Menjëherë pas miratimit të ligjit organik të KLSH-së me Vendimet respektive të Kryetarit u ngritën grupet e punës për përgatitjen e finalizimin e disa dokumenteve bazike të veprimtarisë së KLSH-së përgjatë vitit 2015 dhe konkretisht:

-Hapi i parë ishte procesi i ***rishikimi të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017*** dhe planit te veprimit për periudhën 2015-2017 miratuar me Vendim te Kryetarit te KLSH-së nr 42 datë 31.03.2015.

Bazuar në Strategjinë e ripunuar ***të gjitha politikat menaxheriale institucionale*** janë fokusuar ne implementimin e Objektivave Strategjike te KLSH-së dhe Planin e Veprimit per periudhen ne vijim.

### **- Hartimi i Strategjisë së implementimit të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit**

Në zbatim të objektivit strategjik òrritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimitò KLSH në Mars të vitit 2013, ka nënshkruar Marrëveshjen së Angazhimit me përfaqësues të IDI dhe EUROSAT-t për Programin e ò3iò Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve. Në kuadër të këtij programi, vendet anëtare të IDI, pjesë e të cilit është dhe Shqipëria, **angazhohen për të**

**hartuar Strategji**, të cilat sigurojnë jo vetëm përshtatjen e Standardeve ISSAI, por mbi të gjitha pajtueshmërinë në implementimin e tyre.

Për këtë një grup i posaçëm u angazhua për hartimin e strategjisë dhe me Vendimin nr 58 datë 30.06.2015 të Kryetarit është miratuar Strategjia dhe Plani i Veprimit të implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit 2015-2016, dhe hartimin e standardeve Kombëtare të Auditimit në vitin 2017.

#### **- Hartimi i manualeve të Auditimit Financiar dhe të Perpuethshmerise**

Në kuadër të zbatimit të kërkesave të Strategjisë së Menaxhimit institucional 2013-2017 , të Strategjisë së Implementimit të ISSAIve dhe të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 Shtylla 6 òMbikqyrja e auditimit të jashtëmò u ngritën Grupet e punës për hartimin e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualin e Auditimit Financiar. Me Vendimin e Kryetarit të K.L.SH nr 196 datë 31/12/2015 u miratuan -Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë.

-Manuali i Auditimit Financiar.

Krahas sa më sipër në Planin e Auditimeve për vitin 2016 do të planifikohen për të kryer **3 auditime pilot Auditime Financiare dhe 10 Auditime të Përputhshmërisë** bazuar në dy Manualet e mësipërme. Po kështu procesi i implementimit të Manualeve do të shoqërohet edhe me trajnime intensive për këto dy lloje auditimi.

#### **-Hartimi i Kodit të ri të etikës së KLSH-së**

-Klsh përgjatë vitit 2015 u angazhua edhe në hartimin e një kodi të ri të etikës i cili u miratua me Vendimin e Kryetarit nr 56 datë 30.04.2015. Kodi etik i KLSH-së reflekton praktikën me të mira të fushës duke u hartuar si një dokument integral ku janë përfshirë : Kodi etik i KLSH-së, Kodi Etik i Gjykatës Europiane të Audituesve dhe ISSAI 30; Kodi i etikës i INTOSAI-t .

#### **-Ndryshimet e strukturës organizative**

Ndryshimet dhe zhvillimet që kanë ndodhur në ambientin veprues të KLSH gjatë viteve të fundit, pritshmëritë që erdhën vijnë si rezultat i miratimit të Ligjit të Ri, nxorën në pah nevojën për rishikim dhe përshtatje të strukturës organizative dhe formave të bashkëveprimit midis njësive të Insitucionit.

Tashmë KLSH disponon një Struktura Organizative efektive e cila përshtat më së miri qëllimet institucionale me detyrat dhe angazhimet e çdo njësie organizative: Departamenti, Drejtorie apo Sektori në kuadrin e objektivave strategjikë të Insitucionit.

Në funksion të arritjes së pritshmërive për modernizimin institucional si dhe implementimin e standardeve Nderkombëtare të Auditimit ISSAI është krijuar dhe funksionon **Departamenti i Politikave të Auditimit**, boshti kryesor i veprimtarisë të të cilit është hartimi i politikave të auditimit dhe mbështetja e Departamenteve të auditimit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre audituese.

Në funksion të objektivit të KLSH për të bërë pjesë të praktikave të saj audituese dhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit u jetësuan me krijimin e një drejtorie të veçantë atë të **Drejtorisë së Auditimit të TI-së** si pjesë e Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Po kështu përgjate vitit 2015 u hartua **Rregullorja e Brëndshme e Organizimit dhe Funkzionimit Administrativ të KLSH-së miratuar me Vendimin e Kryetari nr 85 datë 30.06.2015** .

Kjo rregullore përmban rregullat për organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së bazuar në parimet e zbatimit me korrektësi të legjislacionit në fuqi, të rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese dhe rritjes së transparencës ndaj publikut.

#### **-Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional i Stafit.**

Edukimi profesional është një nga komponentët më të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, identifikimin e mundësive për zhvillim të mëtejshëm dhe për më tepër krijimin e òtrupës profesionale në një Institucioni të Auditimit Suprem.

Në funksion të arritjes së këtij objektiv, trajnimi në KLSH është ndërtuar dhe vijon të zhvillohet si një veprimtari e konsoliduar dhe e planifikuar që ka si qëllim të mbështesë dhe ndihmojë zhvillimin profesional të audituesve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre individuale dhe të Institucionit në përgjithësi. Krahas trajnimit, zhvillimi profesional i referohet mundësive për të mësuar dhe është projektuar për të nxitur dhe mbështetur rritjen profesionale të audituesve si dhe krijimin e një vizioni për të ardhmen.

Programi i Trajnimit për Stafin e KLSH, i vitit 2015 përfshiu veprimtari të trajnimit dhe zhvillimit të parashikuara për t'u ofruar audituesve dhe punonjësve aftësi, dhe mjeshtëri specifike si dhe njohuri të përditësuara të domosdoshme për kryerjen misionit dhe ushtrimin me sukses të detyrës së audituesit publik. Si rezultat i implementimit të Programit të Trajnimit gjatë vitit 2015, KLSH ka siguruar që numri i ditëve për trajnim për person të jetë i njëjtë me SAI-t moderne e më të përparuar.

#### **-Projekti IPA**

Në kuadër të asistencës për Shqipërinë dhe të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit, IPA 2013, komponenti i I-rë, KLSH ka fituar një financim nga Bashkimi Evropian për **"Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm"** me vlerë 2.11 milionë euro.

Përgjate vitit 2015 janë përfunduar modalitetet dhe nënshkruar kontrata dhe Zbatimi i Projektit IPA 2013 të KLSH-së, nis në fillim të vitit 2016 . Zbatimi i projektit IPA 2013 i cili e profilizon KLSH si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon tërësisht aktivitetin e tij në standardet e INTOSAI-t.

Për shkak të mosfillimit të projektit IPA gjatë 2015 fondi i parashikuar si Kosto Lokale prej 6.9 milionë lekë rezultoi i pashpenzuar, po kështu dhe fondi prej 30 milionë lekë Financim i Huaj.

**10.** Ne frymën e standardeve të INTOSAI, konkretisht ISSAI 20, për transparencën dhe llogaridhënien, KLSH gjatë vitit 2015 ka realizuar 16 botime.

#### **Seria e botimeve të Kontrollit të Larte të Shtetit për vitin 2015**

<b>Nr.</b>	<b>Titulli</b>
<b>1</b>	Konferenca e III-te Shkencore (botimi ne gjuhen angleze)
<b>2</b>	Revista "Auditimi publik" nr. 9 (shtator-dhjetor 2014)
<b>3</b>	Standartet e GAOs
<b>4</b>	Analiza vjetore, 2014
<b>5</b>	Indikatorët e Performancës

6	Manuali i Departamentit te Auditimit te Performances
7	Manuali i Auditimit te IT (100 faqe) &ISSAI 5310 òMetodologjia e Rishikimit të Sigurisë të Sistemeve të Informacionitò
8	Audituesit e KLSH-se ne Shtypin e përditshëm, Volumi III(korrik-dhjetor 2015)
9	COBIT 4.1, Objektivat e kontrollit të Teknologjisë së Informacionit (faqe 380)
10	Revista "Auditimi publik" nr. 10 (janar-prill 2015)
11	Kodi Etik
12	90 vjetori i institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit
13	Revista "Auditimi publik" nr. 11 (maj-gusht 2015)
14	Raporti Vjetor i Performances 2014
15	Audituesit e KLSH-se ne Shtypin e përditshëm, Volumi IV(janar-qershor 2015)
16	Albumi i 90 vjetorit te KLSH-se

***KLSH ne vijim me burimet financiare disponibel do të vazhdojë përpjekjet institucionale të cilat synojnë modernizimin dhe reformimin e institucionit me qëllim që të reflektojmë tiparet dhe standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI dhe fokusimin e veprimtarisë audituese me impakt, forcimin e llogaridhënjes publike, të integritetit, transparencës institucionale.***